



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 01.10.2013
Nr. 0204-1271

PËR: Blerim Kuçi, Kryetar i Komunës së Suharekës
Veseli Maliqaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SUHAREKËS, Nr. 16-7334, të pranuar me datën 30.09.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 16-7334,, të miratuar me datë 26.09.2013 nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr. 16-7334, për lejimin e ndarjes së parcelave kadastrale në zonat e parapara për vendbanime.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 01.10.2013
br. 0204-1271

Za: Blerim Kuçi, Gradonačelnik opštine Suva Reka
Vesel Maliqaj, Predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Suva Reka , br.16-7334,
primljeno dana 30.09.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 16-7334,, **odobreno dana 26.09.2013** od strane Skupštine opštine Suva Reka , **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka br. 16-7334, o dozvoli dodele kadastarskih parcela u predviđenim područjima naselja.


Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a.

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY - SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të dispozitave të nenit 3, 4, 5 dhe nenit 7, paragrafi 5, të Ligjit mbi token ndërtimore, nenit 12, 14 dhe 17, të Ligjit, Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 15 dhe 29 pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nenit 14, të Ligjit, Nr. 2003/14, për planifikim hapësinor, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 26.09.2013, mori këtë:

04/L-174

V E N D I M

Për lehtësimin e ndarjes së parcelave kadastrale në zonat e parapara për vendbanim

Neni 1.

LEJOHET ndaria e parcelave kadastrale që sipas Planit Zhvillimor Komunal janë zona të parapara për vendbanim dhe regjistrimi i tyre në regjistrin kadastral, konform kushteve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës.

Neni 2.

Sipërfaqja minimale që duhet të ketë një parcelë ndërtimore e krijuar me ndarje, nuk mund të jetë më e vogël se 300m².

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër, e Komunës së Suharekës.

Neni 4.


Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 18, të Rregullores, Nr-01/2013, për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 5.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet, Vendimi me numër 01-Nr-16-3230 i datës, 30.06.2011.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-16-7334
Më datë 26.09.2013.



Kryesuesi i Kuvendit

Veseli Maliqaj